

# Plani Strategjik i Veprimit 2021 - 2023

# Plani Strategjik i Veprimit 2021 - 2023

## PËRMBAJTJE

NË VEND TË HYRJES	04
MISIONI	05
VIZIONI	05
VLERAT	05
ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	06
QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT PÛRKATËSE	07
1. SIGURIMI DHE NXITJA E DIVERSITETIT DHE PLURALIZMIT	07
2. PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE EFEKTIVITETIT TË ROLIT TË MBIKËQYRJES DHE RREGULLIMIT	07
3. QASJE PROAKTIVE PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE TË PËRGJEGJSHME	08
4. NGRITJA E KAPACITETEVE DHE MIRËQEVERISJA	08
TABELA E PLANIT STRATEGJIK	09

# Në vend të hyrjes

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me përvojën 21 vjeçare si ent rregullator në fushën e mediave, ka ndikuar në ndryshimet e thella në këtë sektor. Këto ndryshime janë nxitur dhe nga faktorë ekonomikë, teknologjikë e shoqërorë. Zhvillimet e shpejta teknologjike, në veçanti digjitalizimi, kanë revolucionarizuar industrinë mediatike, duke sjellë, për tregun audioviziv, sfida e mënyra të reja për t'i shërbyer publikut, pa i cenuar vlerat e tij themelore. Përballë këtyre ndryshimeve, AMA ka zgjedhur një qasje gjithëpërfshirëse, bazuar në një rregullim brenda kornizave ligjore.

Si një autoritet i pavarur, AMA ka synuar të forcojë dhe të konsolidojë rolin e vet në monitorimindhembikëqyrjen e mediave audiovizive. Përmes masave vendërgjegjësuere e parandaluese, por edhe me anë të sanksioneve të vendosura, janë arritur rezultate pozitive në veprimtarinë e Autoritetit dhe të operatorëve audiovizivë. Bashkëpunimi me organet e tjera ligjzbatuese ka përmirësuar funksionet e AMA-s dhe ka ndikuar në zbatimin e kërkesave ligjore. AMA ka intensifikuar bashkëpunimin me partnerët mediatikë, për projekte mbi studimin e tregut apo zhvillimin e veprimtarisë trajnuese me gazetarët e redaktorët, në favor të përmirësimit të performancës e të respektimit të Kodit të Transmetimit.

Në politikën e vet të menaxhimit të burimeve njerëzore, AMA e ka vënë theksin te profesionalizmi, rezultatet dhe transparenca në shërbim, duke krijuar kështu bazat për një administratë dinamike në punën e përditshme, për realizimin e objektivave në vijimësi. Rritja e numrit të ankesave, vit pas viti, ka treguar dhe rritjen e besimit të publikut tek Autoriteti.

Hartimi i kësaj strategjie u parapri nga një analizë gjithëpërfshirëse e përparimit të bërë në këto vite, si dhe nga parapërgatitja për sfidat që na presin në të ardhmen. Vitet e fundit kanë shënuar hapa pozitivë në të gjitha drejtimet e mësipërme, por, padyshim, ka hapësira për përmirësime të mëtejshme. Angazhimi i AMA-s në rregullimin e veprimtarisë së mediave audiovizive vijon të mbetet ndër qëllimet kryesore.

Kriza COVID-19 po prodhon sfida të pashembullta për sektorin audioviziv.

Tregu audioviziv në Republikën e Shqipërisë, për herë të parë nga fillimi i vitit 2020, është nën ndikimin e efekteve që ka shkaktuar dhe vijon të shkaktojë COVID 19, duke rrudhur hapësirat e performancës, duke rishikuar planet e biznesit, për të gjithë OSHMA-të e licencuara/autorizuara.

Sektori audioviziv luan një rol jetësor në mbështetje të shoqërisë, familjeve e individëve, përgjatë kohës që ne po përshtatemi me mënyrën e re të jetesës, punës e komunikimit, në situatën e pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi.

Pasojat e COVID-19 u ndjenë edhe në procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive. Kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë, nevoja për shmangien e grumbullimit të njerëzve në pikat e shitjeve të dekoderave si dhe faktorë të tjerë cuan në shtyrjen e afateve të përcaktuara nga AMA përgjatë vitit 2020.

Vazhdimësia e komunikimit nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme!

Ndikimi dhe pasojat e pengesave dhe problematikave, që po shkakton pandemia, reflektohen dhe në këtë dokument strategjik të veprimtarisë së AMA-s, për periudhën 2021-2023. Janë konceptuar, planifikuar dhe përshtatur veprimtari që, në fund të fundit, garantojnë ecje të qëndrueshme, në një kontekst të situatës së pazakontë, që po kalon vendi. Prandaj, që nga konsultimi publik, ne e kemi rishikuar planin tonë të veprimit, në kushtet e pandemisë COVID-19.

## I. Misioni

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka misionin të sigurojë që të gjitha shërbimet audio dhe audiovizive të përmbushin nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe moralin qytetar, në përputhje me vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

## II. Vizioni

AMA, si institucion i pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, nxit: (i) shumëllojshmërinë dhe cilësinë e lartë e me risi të programeve nga OSHMA-të publike e private; dhe (ii) zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimeve në përputhje me dispozitat ligjore, për përmbajtje të paanshme në kuadrin e të drejtës për informim, në respektim të përkatësisë fetare dhe politike, personalitetit, dinjitetit, të drejtave dhe lirive të tjera themelore të njeriut, duke i mundësuar kështu publikut të krijojë opinionin e vet të lirë.

## III. Vlerat

Vlerat, në bazë të të cilave AMA zhvillon funksionet dhe veprimtarinë e saj:

- Mbështetë lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediatike audiovizive, ***motivuar nga interesi publik.***
- Ruan një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin/autorizimin dhe

rregullimin e shërbimeve mediatike audiovizive, **në respektim të drejtësisë, paanshmërisë dhe konkurrencës së lirë.**

- Krijon qëndrueshmëri financiare të institucionit, nëpërmjet përdorimit të burimeve të tij me efikasitet, gjatë përmbushjes së detyrave dhe nevojave të Autoritetit, **duke u udhëhequr nga transparenca dhe llogaridhënia.**

## IV. Analiza e situatës aktuale

Objektivat e përcaktuara për t'u realizuar nga AMA, në Strategjinë 2017-2019, janë përmbushur, përgjithësisht, brenda afateve të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie.

Duhet të marrim gjithnjë në konsideratë faktin se ka objektiva të cilat zgjaten në kohë, përderisa përkojnë me procese të vijueshme të punës së Autoritetit. Për shkak të zhvillimeve të reja apo ndryshimeve a përmirësimeve të kuadrit ligjor, këto objektiva do të mbeten edhe në Planin e Veprimit të Strategjisë 2021-2023.

Në vijim, lidhur me sa më sipër, po rendisim përmirësimin e rregullave për administrimin e sistemeve TIK në institucion; koordinimin e frekuencave të brezit audioviziv; pasurimin e Buletinit Periodik të AMA-s mbi informacionin për sektorin e mediave audiovizive; performancën e Transmetuesit Publik dhe të OSHMA-ve të tjera; intensifikimin e bashkëpunimit me partnerët mediatikë për projekte mbi studimin e tregut a zhvillimin e veprimtarisë trajnuese me gazetarët e redaktorët, në favor të përmirësimit të performancës në respekt të Kodit të Transmetimit; bashkëpunimin ndërinstitucional nëpërmjet hartimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit; hartimin e rregullave të reja dhe udhëzimeve të brendshme procedurale në funksion të forcimit të institucionit; zhvillimin organizativ dhe politikat e komunikimit të AMA-s etj.

Konkretisht, miratimi i dy rregulloreve: “Udhërrëfyes (rregullore) për zgjidhjen e konfliktit midis operatorëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik” dhe “Rregullore për kriteret dhe masat që rregullojnë bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të Transmetuesit Publik”, ka qenë pjesë e Strategjisë së AMA-s 2017-2019. Për shkak të orientimit të veprimtarisë së AMA-s drejt përmbushjes së detyrimeve për kalimin në transmetimet numerike, miratimi i këtyre akteve është zhvendosur në Planin e Veprimit të Strategjisë 2021-2023.

## V. Qëllimet strategjike dhe objektivat përkatëse

Qëllimet strategjike të AMA-s, për një periudhë kohore tre vjeçare. Secili qëllim përmban objektiva strategjike të veçanta, si vijon:

### 1. Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit

- a. Krijimi i lehtësirave në ofrimin e një panorame mediatike pluraliste dhe pasqyrimi i vlerave, aspiratave dhe identitetit të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet nxitjes së debatit demokratik dhe gjithëpërfshirjes.
- b. Nxitja e promovimit të prodhimit programor audioviziv cilësor në gjuhën shqipe si dhe sigurimi i rritjes së shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive nga OSHMA-të publike dhe private.
- c. Mbrojtja e pluralizmit nga AMA, nëpërmjet forcimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimeve transmetuese, marrëveshjeve për licencimin e OSHMA-ve, si dhe, në veçanti, çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.

### 2. Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit

- a. Përmirësimi i zbatueshmërisë së kodeve dhe rregullave të transmetimit, njohja e përballimi i sfidave të rregullimit, përkatësisht amendimi dhe hartimi i legjislacionit, krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike, në harmoni me legjislacionin e BE-së, si dhe mënyrat dhe format e zbatimit të tyre në praktikë.
- b. Riaktivizimi i iniciativës së AMA-s dhe koordinimi i tërësishëm, me të gjithë faktorët institucionalë, në luftën kundër piraterisë dhe në mbrojtjen e të drejtave të autorit.
- c. Vijimi i mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në, duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të saj përmes garantimit të konkurrencës së ndershme, në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj.

### 3. Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme

- a. Hartimi dhe realizimi i një sërë veprimtarive që promovojnë edukimin mediatik, duke nxitur aftësinë e audiencave për të vlerësuar dhe kuptuar përmbajtjet audiovizive, në një mjedis mediatik në zhvillim.
- b. Realizimi, organizimi, mbështetja dhe nxitja e kërkimit, duke përfshirë bashkëpunimin me publikun, transmetuesit dhe palët e tjera të interesuara, për të pasur një përfshirje aktive në çështjet e rregullimit të transmetimeve audiovizive.

### 4. Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja

- a. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, nëpërmjet fuqizimit të besueshmërisë së publikut, duke zbatuar procese dhe procedura që janë të hapura e të kontrollueshme, si dhe duke publikuar raportime të qarta e periodike mbi punën e tij, me vëmendje të veçantë ndaj procesit të monitorimit të ankesave.
- b. Vijimi i lehtësimit të barrës burokratike, për subjektet që autoriteti licencon/autorizon, duke kërkuar mënyra më efikase për të arritur qëllimet e tij.
- c. Ngritja e kapaciteteve të institucionit nëpërmjet trajnimit të stafit aktual apo nëpërmjet shkëmbimit të praktikave të mira me autoritetet rregullatore rajonale, evropiane etj.
- d. Përmirësimi i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit, për të shmangur rreziqet e mundshme nga sulmet apo hyrjet e paautorizuara në sistemin TIK, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe qasjes në publik.

## Tabela e Planit Strategjik



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Kalimi në transmetimet numerike</b>						
Ndjekja e zbatimit të Strategjisë së Kalimit në Transmetimet Numerike Audiovizive.	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Koordinimi me operatorët privatë kombëtarë numerikë, lidhur me shtrimin e infrastrukturës numerike në qarqet e mbetura (Dibër, Kukës, Gjirokastër)<sup>1</sup>.</li> <li>-Koordinimi me operatorët lokalë/rajonalë për mbështetjen e programeve të tyre në njërin nga rrjetet kombëtare;</li> <li>-Organizimi i fushatës së informimit të publikut në qarqet ku nuk ka përfunduar procesi i digjitalizimit.</li> <li>-Monitorim në terren me qëllim verifikimin e mbulimit të territorit me sinjal numerik si dhe për të garantuar cilësi të mirë transmetimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Përbushja e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për kalimin e plotë nga transmetimet analoge në transmetimet digjitale.</li> <li>-Rritje e numrit të kanaleve televizive, të cilat ofrohen pa pagesë për publikun.</li> <li>-Cilësi e lartë transmetimi krahasuar me transmetimet analoge.</li> <li>- Rritje e konkurrencës në treg e cila do të çojë edhe në rritjet e cilësisë së përmbajtjeve televizive.</li> </ul>	X			Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
Ndjekja e zbatimit të akteve përfundimtare, të miratuara në konferencën ndërkombëtare WRC 15. Lirimi i brezit të Dividendit Digjital 2. Ndjekja e marrëveshjeve shumëpalëshe me vendet e rajonit.	Bashkëpunimi dhe koordinimi me MIE dhe AKEP, në lidhje me zbatimin e strategjive që duhet të ndiqet nga qeveria shqiptare, në lidhje me politikat spektrale.	Harmonizimi i përdorimit të spektrit të frekuencave, duke garantuar një përdorim efikas të spektrit në përputhje me politikat e BE-së në fushën e transmetimeve audiovizive.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
	<p>Ndjekja e procesit të lirit të brezit 700 MHz (brezi DD2), në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit dhe Parlamentit Evropian, në bashkëpunim me të gjithë palët e përfshira në këtë proces:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë dhe studim mbi optimizimin e frekuencave të brezit UHF, duke përjashtuar brezin DD2, me qëllim ruajtjen e numrit të operatorëve në treg si dhe ruajtjen e kapaciteteve transmetuese.</li> <li>• Koordinim i vazhdueshëm me operatorët audiovizivë në treg, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve efektive teknike.</li> <li>• Koordinim ndërkufitar me vendet fqinje për përdorimin e brezit UHF, duke përjashtuar brezin DD2.</li> </ul>	Lirimi i brezit 700 MHz dhe vënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e internetit me shpejtësi të lartë (5G). Garantimi i vazhdimësisë së tërë transmetimeve audiovizive në rrjetet tokësore si dhe ruajtja e kapaciteteve transmetuese pas lirit të brezit DD2.	X	X		Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
	Ndjekja dhe zbatimi i marrëveshjeve shumëpalëshe me vendet e rajonit 1, ku bën pjesë edhe Shqipëria si dhe koordinimi i frekuencave me këto shtete lidhur me përdorimin e frekuencave audio/audiovizive.	Shmangia e interferencave të mundshme me vendet e Rajonit 1, ku bën pjesë Shqipëria.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.

<sup>1</sup> AMA me vendimin nr.82, datë 08.10.2020 ka vendosur të përcaktojë si afat për kalimin në transmetimet numerike, në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastër datën 30 dhjetor 2020.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Kalimi në transmetimet numerike</b>						
Monitorimi i shfrytëzimit të spektrit frekuencor audio/audioviziv.	<p>Monitorim periodik i shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv me qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shmangien e interferencave të dëmshme të shkaktuara në apo nga brezi audio/audioviziv.</li> <li>• Identifikimin e transmetimeve të paligjshme.</li> <li>• Identifikimin mbi zbatueshmërinë e kushteve të licencës nga ana e operatorëve audio/audiovizivë.</li> <li>• Mbështetjen e procesit të planifikimit të spektrit audio/audioviziv.</li> </ul>	Rregullimi i tregut audio/audioviziv lidhur me përdorimin e frekuencave me efektivitet, si dhe duke shmangur interferencat e mundshme. Sigurimi i konkurrencës së ndershme në treg.	X	X	X	Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	<p>Monitorim dhe vlerësim lidhur me mbulimin me sinjal numerik të territorit nga operatori publik shqiptar (RTSH) dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim dhe koordinim me operatorët kombëtarë numerikë (publik dhe privatë), me qëllim realizimin e mbulimit të territorit të vendit me sinjal numerik.</li> </ul>	Identifikimi i zonave të pambuluara me sinjal numerik nga RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë, si dhe gjetja e zgjidhjeve teknike, për të pasur një mbulim të mirë dhe cilësor në të gjithë vendin.	X	X		Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
<b>Kuadri ligjor, aktet nënligjore dhe politikat</b>						
	Rishikimi i rregullore për planin e renditjes së shërbimeve mediatike audiovizive, që mbështeten në rrjete numerike.	Rregullimi i tregut të transmetimeve audiovizive.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Ndryshim në Rregullore për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës numerike kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencave kombëtare për shërbimin e programit audioviziv (v.218/2016) për brezin VHF.	Shtimi i numrit të rrjeteve numerike, duke rritur dhe numrin dhe larminë e shërbimeve programore për publikun.			X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
	Vendim për detyrimin e mbartjes së programeve kombëtare (Must Carry).	Garantimi i aksesit në transmetimet e shërbimeve publike dhe ofrimi, për publikun, i një shumëllojshmërie programesh.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Ndryshime në rregulloren për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës audio.	Rregullimi i tregut të transmetimeve radio.	X			Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Kuadri ligjor, aktet nënligjore dhe politikat</b>						
	Rishikimi i Kontratës së Transmetuesit Publik (AMA-RTSH)	Garantimi i përbushjes së rolit të RTSH-së si operator publik, për sigurimin e një shumëllojshmërie programesh që i drejtohen publikut të gjerë. Realizimi i monitorimit dhe vlerësimit të përmbajtjeve të buketës programore çdo 6 muaj. Gjithashtu, në kuadër të shqyrtimeve tematike për të gjithë OSHMA-të do të përfshihet dhe RTSH.		X		Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Rishikimi i Kodit të Transmetimit	Ndërhyrje në Kodin e Transmetimit të AMA-s, për të reflektuar përmirësime në drejtim të informimit objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit. Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Udhërrëfyes (rregullore) për zgjidhjen e konfliktit midis operatorëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik.	Procedurat që do të përdorë AMA në rast mosmarrëveshjes midis operatorëve privatë dhe/ose transmetuesit publik, lidhur me veprimtarinë e tyre audiovizive.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Rregullore për kriteret dhe masat që rregullojnë bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të RTSH-së.	Akti synon të përcaktojë rregullat dhe procedurat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të RTSH-së nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv të licencuar për transmetime tokësore audio/audiovizive.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
<b>Infrastruktura e informacionit dhe njohurive</b>						
Zhvillimi dhe zbatimi i njohurive organizative.	Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i një plan aksioni, i cili mbështet përputhshmërinë dhe praktikën e mirëqeverisjes nga të gjithë transmetuesit e licencuar dhe kontraktues.	Sigurimi i metodave më të mira të punës dhe përdorimi i të dhënave në mënyrë efektive, për zbatimin e proceseve të reja.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
	Zhvillimi dhe zbatimi i Strategjisë së Rishikuar të Transmetimeve, e cila do të mundësojë politika licencuese dinamike dhe do të promovojë prodhimin programor cilësor në gjuhën shqipe.	Rritja e prodhimit dhe shumëllojshmërisë së një përmbajtjeje audiovizive me nivel të lartë kulturor, për audiencën shqiptare.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.





FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Infrastruktura e informacionit dhe njohurive</b>						
	Zhvillimi dhe zbatimi i një plan-aksioni, i cili nxit përfaqësimin e diversitetit të shoqërisë shqiptare në media, me një fokus të veçantë në çështjet gjinore dhe gjuhën shqipe.	Përmirësimi i raportimit, nga redaksitë audiovizive, në trajtimin e tematikave të ndryshme, me fokus të veçantë aspektet gjinore dhe gjuhën shqipe.		X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Vijimi i përkrahjes dhe rishikimit të skemave të financimit, që mbështesin një rritje të prodhimit dhe shumëllojshmërisë së përmbajtjeve të ndryshme, të reja e me nivel të lartë kulturor për audiencën shqiptare, përfshirë përmbajtje në gjuhën shqipe.	Përmirësimi i raportimit, nga redaksitë audiovizive, për trajtime të shumëllojshme dhe cilësore.		X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
Buletini Periodik i AMA-s, mbi informacionin për sektorin e mediave audiovizive.	Zgjerimi i fokusit të faktorëve dhe treguesve nga dinamika e tregut audioviziv shqiptar, përmbajtja e programeve, infrastruktura, karakteristikat teknike, ekonomia dhe financat, burimet njerëzore etj. Promovimi i studimeve, analizave dhe vlerësimeve, duke përfshirë edhe ekspertizën e jashtme.	Publikimi i një baze të të dhënave të dobishme për palët e interesuara, studiuesit e tregut audioviziv dhe studentët, institucionet, qytetarët etj.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
Rishikimi i tarifave për licenca\autorizime dhe shërbime të tjera.	Kryerja e një analize të përditësuar mbi kërkesat financiare të AMA-s, bazuar në funksionet, proceset, procedurat e brendshme dhe shërbimet, për të arritur një skemë të harmonizuar dhe transparente të tarifave të licencave/autorizimeve dhe shërbimeve të tjera.	Autonomia financiare e AMA-s.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Matja e audiencës televizive	Promovimi i një dialogu ndërinstucional, me përfshirjen e palëve të interesuara, me qëllim garantimin e një procesi të rregulluar të matjes së audiencës audiovizive.	Organizim tryezash me aktorët kryesorë të përfshirë në matjen e audiencës televizive, në mënyrë që të gjendet një mekanizëm për monitorim të tregut mediatic.	X	X		Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Hartimi dhe realizimi i një sërë veprimtarish të edukimit mediatic, i cili rrit aftësinë e audiencave për të vlerësuar dhe kuptuar përmbajtjet audiovizive, në një mjedis mediatic në zhvillim.	Bashkëpunim dhe sinergji me ekspertë të fushës së medias, të Fakultetit të Gazetarisë, hulumtime dhe studime për të kuptuar problemet të mjedisit të mediave audiovizive, dhe për të gjetur zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e situatës.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Infrastruktura e informacionit dhe njohurive</b>						
Infrastruktura informatike e AMA-s	Përmirësimi i procedurave në lidhje me administrimin, monitorimin e sistemeve dhe proceseve TIK. Përmirësimi i proceseve të AMA-s me anë të shërbimeve dhe infrastrukturës së TIK.	Sigurimi i mirëfunksionimit të infrastrukturës TIK në institucion dhe parandalimi i sulmeve apo hyrjeve të paautorizuara në sistemet TIK të institucionit, me qëllim garantimin e sigurisë së sistemeve TIK.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Infrastruktura e arshivës së AMA-s	Përmirësimi i procedurave të arkivimit të materialeve audio dhe video.	Mirëfunksionimi dhe shtimi i kapaciteteve të infrastrukturës së arshivës, duke bërë të mundur ruajtjen e materialeve për një periudhë të gjatë, si dhe në kushte të përshtatshme.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
<b>Veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe përputhshmërisë</b>						
Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve dhe infrastrukturës teknike, për matjen e përputhshmërisë së cilësisë së shërbimit audioviziv.	Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi në 12 qarqet e vendit, ku në kohë reale të bëhet kontrolli i subjekteve televizive mbi transmetimet e tyre. Kjo do të ndihmonte në një kontroll më të mirë të situatës së cilësisë së sinjalit, ndryshimet dhe mbartjet e ndryshme të kanaleve nga një operator në tjetrin, si dhe kontroll të televizioneve vendore, për programet e transmetuara nga këto të fundit.	Rritja e aftësisë monitoruese të programacionit të subjekteve vendore, gjë që ndihmon si në një kontroll më të mirë të sinjalit të transmetimit si në një kontroll më rigoroz të programeve që ato transmetojnë, duke monitoruar më mirë respektimin e të drejtës së transmetimit dhe të autorit.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
Mbrojtja e të miturve. Mbrojtja ndaj nxitjes së gjuhës së urrejtjes dhe dhunës.	Përforsimi i mbrojtjes në TV dhe platformat Video-On-Demand, kundër nxitjes së dhunës ose urrejtjes dhe provokimit publik për të kryer vepra terroriste.	Mbrojtje e përforcuar në TV dhe platformat Video-On-Demand, kundër nxitjes së dhunës ose urrejtjes.  Për platformat Video-Sharing: sigurimi i masave të përshtatshme, për të mbrojtur njerëzit nga nxitje të dhunës ose urrejtjes dhe përmbajtjeve që përbëjnë vepra penale.	X			Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Mbrojtje më e mirë e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme.	Komunikim me institucione dhe organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga redaksitë audio dhe audiovizive, që mbulojnë aspekte të të drejtave dhe lirive të të miturve në tryeza pune, seminare dhe workshop-e, për problematika dhe sfida që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet audio dhe audiovizive.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe përputhshmërisë</b>						
	Reklamata audiovizive për fëmijët.	Bashkëpunim dinamik, me institucionet shtetërore përkatëse dhe grupet e interesit, për vlerësimin dhe monitorimin e përmbajtjeve audiovizive për fëmijët, kryesisht të reklamave për pijet e gazuara dhe ato me sheqer të shtuar; tryeza dhe takime për të shpjeguar dhe sensibilizuar rëndësinë e mbrojtjes së të miturve nga reklama të tilla, si dhe mundësinë e përmirësimeve ligjore për këtë çështje.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Transmetimet me gjuhën e shenjave.	Vazhdimi i komunikimit intensiv me OSHMA-të që kanë detyrim ligjor transmetimet me gjuhën e shenjave dhe gjetja e mekanizmave ligjorë që operatorët ta përmbushin këtë detyrim.	X	X		Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
Kuadri rregullator mbi mbrojtjen e të drejtës së autorit.	Bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Kulturës dhe me SUADA-n, në lidhje me zbatimin e të drejtave të autorit. Takime dhe tryeza me operatorët dhe ndërgjegjësim i tyre mbi respektimin e të drejtave të autorit.	Përmbushje të detyrimit që kanë OSHMA-të mbi respektimin e të drejtës së autorit. Arritja e një konsensusi përfundimtar mbi subjektet që menaxhojnë këto të drejta në vendin tonë, si dhe bashkëpunim me këto të fundit.	X	X		Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
Fuqizim i kapaciteteve teknike për zbulimin e piraterisë televizive.	Implementimi i një infrastrukture teknike të përditësuar, për të evidentuar përmbajtjet audiovizive të paligjshme, të transmetuara në rrjetet e reja të komunikimit (IPTV, OTT).	Identifikimi i subjekteve që transmetojnë (piratojnë) përmbajtje audiovizive pa autorizim nga AMA.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Trajnim teorik dhe teknik i stafit specifik të AMA-s, që merret veçanërisht me njohjen e teknologjive të reja të IPTV/OTT.	Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve të institucionit për transmetimet në rrjetet e reja të komunikimit (IPTV/OTT).		X	X	
Lufta kundër piraterisë	Bashkëpunim dhe koordinim i përbashkët me institucionet e tjera, si AKEP-i, Policia e Shtetit dhe Krimi Ekonomik. Ngritja e grupeve të përbashkëta të inspektimit në subjektet ISP.	Bashkëpunimi me AKEP-in dhe institucionet e tjera ligjzbatuese do të ndihmojë në parandalimin dhe uljen e këtij fenomeni në vitet në vazhdim.	X	X	X	Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Transmetimi</b>						
Rregullimi i teknologjive të reja në shërbimet e transmetimit audio.	Bashkëpunim me palët e përfshira në këtë proces. Sigurimi i kuadrit rregullator që do të rregullojë teknologjinë e re T-DAB (Terrestrial Digital Audio Broadcasting - Transmetimet Tokësore Audio Digjitale).	Rregullimi i transmetimeve të reja audio në teknologjinë T-DAB.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
Implementimi i teknologjisë së transmetimit audio T-DAB.	Studimi dhe analizimi i një zbatimi teknik të planifikimit të frekuencave T-DAB, në përputhje me marrëveshjen GE06 dhe marrëveshje shumëpalëshe midis vendeve të rajonit, lidhur me alokimet e spektrit frekuencor VHF.	Rritja e cilësisë së shërbimit dhe diversifikimi i programacionit të shërbimit audio, nëpërmjet teknologjisë së re digjitale T-DAB.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
<b>Veprimtaritë e licencimit</b>						
Zhvillimi dhe zbatimi i planit të licencimit për shërbimet e transmetimit.	Hartimi i një plan zbatimi për tre vitet e ardhshme.	Hartimi dhe implementimi i planit të licencimit për shërbimet e transmetimit, gjatë tre viteve të ardhshme.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
Licencimet e reja	Studim i mundshëm, në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera të përfshira në këtë proces, për të vlerësuar ndikimin e lirimit të spektrit DD2, në fokus të licencimeve audiovizive tokësore lokale dhe rajonale.	Rregullimi i tregut mediatic.	X	X		Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit.
<b>Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencës</b>						
Plani analitik i përmbajtjes së mediave	Analiza tematike, e fokusuar në çështjet më të spikatura në transmetimin e përmbajtjes së ofruesve të shërbimeve audiovizive. Propozimet e tematikave, kryesisht, vijnë në kuadër të rekomandimeve nga Kuvendi, propozime nga Këshilli i AMA-s, ankesat etj.	Bazuar mbi ankesat, tipologjinë e tyre dhe subjektet me më shumë shkelje/probleme në përmbajtjen që emetojnë, identifikim i çështjeve problematike, analiza e tyre dhe sensibilizim i përbashkët me operatorët për zgjidhjen e tyre. Do të kenë përparësi, si dhe deri më tani, mbrojtja e fëmijëve, reklamat, përmbajtjet e shëndetit dhe medikamentet, gjuha e urrejtjes, standardi i shqipes së folur dhe të shkruar etj.).	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencës</b>						
Transmetimet e operatorit publik dhe operatorëve të tjerë audiovizivë.	Një studim tregu, që përcakton se ç'mund të presin shikuesit dhe dëgjuesit nga transmetuesit, veçanërisht nga transmetuesi publik, në mënyrë që ata të jenë në dijeni të nevojave në zhvillim të audiencës dhe të përshtatin shërbimet e tyre për të përmbushur këto nevoja.	Intensifikim i kontakteve me OSHMA-të, sidomos me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave, takime dhe tryeza të përbashkëta, për t'i sensibilizuar ata për zbatimin sa më të mirë të Kodit të Transmetimit dhe të normave ligjore dhe morale.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
Shqyrtimi i ankesave	Shqyrtimi i zbatimit të Kodit të Transmetimit për praktikatat e dërgimit e shqyrtimit të ankesave.	Përmirësimi i mëtejshëm i Kodit të Transmetimit, pas një procesi të gjerë konsultimi publik. Rishikimi periodik, që synon përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe si detyrim ligjor, bazuar në praktikatat e deritanishme, problemet e evidentuara dhe propozimet e mundshme nga grupet e interesit.	X			Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.
	Bashkëpunimi me institucionet përkatëse, shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë, në arritjen e rezultateve konkrete për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë.	AMA luan rol nxitës, shtytës apo motivues për shoqatat dhe grupimet, që të vijojnë procesin e arritjes së rezultateve konkrete për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve audiovizivë.	X	X		Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Të nxisë rritjen e pjesëmarrjes së publikut në transmetimin mediatik, veçanërisht në respekt të shërbimeve mediatike komunitare.	Organizimi i anketimeve dhe sondimeve të opinionit publik mbi vlerësimet e tyre për përmbajtjet audio dhe audiovizive. Këto do të realizohen me ndihmën e njëjësive ose institucioneve të specializuara të anketimit / sondimit.	X			Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Të zbatohet apo të rishikohet plan-veprimi vjetor i komunikimit të KA-së, sipas nevojave, i cili angazhon dhe informon aktorët dhe palët e interesuara, veçanërisht publikun, në mënyrë thelbësore dhe periodike.	Bazuar në planin e veprimit vjetor të komunikimit të KA-së, bazën nënligjore mbi shqyrtimin e ankesave, si dhe përfshirjen e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave, të ngritura pranë OSHMA-ve, do të mbahen të informuar, në mënyrë periodike, publiku, OSHMA-të, palët e interesuara për të gjithë procesin e shqyrtimit të ankesave. Ky proces do të përfshijë dhe konkluzionet përkatëse, në shërbim të transparencës dhe kërkesave ligjore.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencës</b>						
Miratimi i një plan veprimi për sensibilizimin publik.	Të sigurohet që rregullat dhe Kodi i Transmetimit, si dhe proceset e ankimit pranë AMA-s, të vijojnë të mbështesin njohuritë, kërkesat, argëtimin dhe bashkëveprimin e audiencës me përmbajtjen audiovizive.	Krijimi i sa më shumë kanaleve komunikuese me publikun dhe OSHMA-të, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sektorit të veçantë, që KA ka në faqen e internetit të AMA-s, si dhe trajtimi profesional i ankesave të adresuara në AMA.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
<b>Komunikimi dhe zhvillimi sektorial</b>						
	Zhvillimi dhe realizimi i aktiviteteve që promovojnë dhe mbështesin krijimtarinë dhe inovacionin në sektorin audioviziv dhe në të gjitha veprimtaritë e AMA-s.	Realizimi, organizimi, mbështetja dhe nxitja e kërkimit, duke përfshirë bashkëpunimin me publikun, transmetuesit dhe palët e tjera të interesuara, për të pasur një përfshirje aktive në çështjet e rregullimit të transmetimeve audiovizive.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Politikat e komunikimit	Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Komunikimit.	Hartimi i planit të punës për të arritur një qasje më frytdhënëse me publikun, OSHMA-të dhe aktorët e tjerë.	X	X		Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
	Përgatitja e publikimi në vijimësi i Raporteve të AMA-s, periodikëve të tillë si Revistat, Buletinet, apo studimi e kërkimi i tregut, do të jenë të vlefshme për publikun.	Rritja e transparencës së AMA-s jo vetëm te subjektet e tregut audioviziv por edhe te publiku apo palë të treta të interesuara.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Bashkëpunimi ndërinstytucional	Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e tjera ligjzbatuese për të përmirësuar funksionet e AMA-s dhe zbatimin e kërkesave ligjore.	Rritja e bashkëpunimit me qëllim garantimin e zbatimit dhe respektimit të legjisllacionit në fuqi, nga subjektet e fushës.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
	Ndjekja e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me Komisionerin për Mbrojtjen e Konsumatorit, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit etj.	Shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave, bashkëpunimi rast pas rasti me këto autoritete, organizimi i takimeve të përbashkëta me qëllim zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.
Intensifikimi i bashkëpunimit me partnerët mediatikë, për projekte mbi studimin e tregut a zhvillimin e veprimtarisë trajnuese me gazetarët e redaktorët, për të përmirësuar performancën, në respekt të Kodit të Transmetimit.	Tryeza pune me transmetuesit, pas futjes së rregullave dhe/ose procedurave të reja ose të rishikuara sipas rastit, studime tregu, konferenca shkencore, forume diskutime me grupe interesi.	Përmirësimi i raportimit nga redaksitë audio dhe audiovizive, si dhe respektimi i kërkesave të Kodit të Transmetimit.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Financat dhe qeverisja</b>						
Menaxhimi financiar dhe raportimi	Menaxhimi i burimeve financiare të AMA-s, respektimi i akteve ligjore dhe akteve nënligjore në praktikën e kontabilitetit dhe raportimi për realizimin e treguesve financiarë të vitit kalendarik. Shqyrtimi i projektbuxhetit bazuar në një seri treguesish të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke siguruar vazhdimësinë e funksionimit të AMA-s, pa cenuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi.	Efikasitet në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, përqendruar në realizimin e objektivave të AMA-s.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Raportimi i brendshëm financiar në lidhje me kanalizimin e burimeve financiare.	- Zhvillimi i strukturës së raportimit, duke kombinuar, në përqindje, realizimin e elementeve që përbëjnë burimet e të ardhurave hyrëse me elementët dalës (shpenzimet / investimet). - Raportimi duhet të kryhet në nivelet e menaxhimit dhe vendimmarrjes. - Raportimi të jetë periodik dhe ad hoc ose, kur është e nevojshme, në rastet e rrethanave të paparashikuara.	Vlerësim i rrezikut dhe minimizimi i situatave të paparashikuara të lidhura me shpenzimet.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Qeverisja	Strategjia organizative	AMA publikon, realizon dhe rishikon objektivat strategjike, për çdo vit.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
	Pavarësia e rregullatorëve audiovizivë është përforcuar në legjislacionin e BE-së, duke siguruar që ata janë, ligjërish, të pavarur nga qeveria dhe nga çdo organ tjetër, publik ose privat.	Përforcimi i pavarësisë së AMA-s. Garantimi i pavarësisë realizohet përmes këtyre elementeve: <i>Statusi, emërimi dhe përbërja e AMA-s</i> (që rregullohet me ligj të posaçëm, që miratohet nga Kuvendi i RSH). <i>Pavarësia financiare dhe përshtatshmëria e burimeve</i> (AMA ka kompetencë të caktojë, me vendim, të ardhurat nga pagesat, element që rrit pavarësinë). <i>Fuqitë dhe kompetencat, pavarësia organizative</i> (p.sh., caktimi i strukturës administrative nga vetë organi rregullator). <i>Përgjegjshmëria kundrejt publikut</i> (transparenca në vendimmarrje, publikimi i vendimmarrjeve, këshillimi publik).	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITË ME PËRPARËSI	REZULTATI I PRITSHËM	AFATI			QËLLIMI STRATEGJIK
			2021	2022	2023	
<b>Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative</b>						
Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative	Zhvillimi i burimeve njerëzore nëpërmjet zbatimit të Manualit të Politikave të Burimeve Njerëzore.	Zbatimi i kërkesave të Manualit (dhe ndryshimeve të tij) për rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të stafit të AMA-s.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
	Përcaktimi i planeve të trajnimit në përputhje me procesin e vlerësimit të rezultateve.	AMA zhvillohet si një institucion që zotëron dije, mëson nga përvoja dhe mbështet thellimin e njohurive të punonjësve.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
Zhvillimi organizativ	Rishikimi i strukturës organizative, në përputhje me proceset ose funksionet e reja apo të ripërcaktuara.	Komunikimi dhe strukturat e brendshme zhvillohen dhe rishikohen në mënyrë dinamike. Zbatohen politika dhe strategji të burimeve njerëzore, që i mundësojnë AMA-s të përmbushë detyrimet e saj ligjore dhe që krijojnë një mjedis pune mbështetës për personelin e AMA-s.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.
	Hartimi dhe zbatimi i një plani trajnimi, për të mundësuar arritjen e objektivave strategjike të AMA-s, për të mbështetur angazhimin e punonjësve dhe për të zhvilluar njohuritë organizative.	AMA punon (në bashkëpunim dhe konsultim, kur është e përshtatshme) për të krijuar dhe ruajtur një mjedis pozitiv pune, për arritjen e objektivave strategjike të institucionit.	X	X	X	Ngritja e kapaciteteve dhe mirëqeverisja.





Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",  
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë  
Tel: +355 4 222 6288;  
+355 4 223 3006  
Cel: +355 67 303 3000  
e-mail: [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al)  
[www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)